

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6693
E mërkurë, 31 gusht 2022
çmimi 0.40

Sindikalistët: Qeveria ta zgjedhë dialogun e jo shantazhet e kërcënimit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA SHËNON DITËN NDËRKOMBËTARE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR

KOSOVA KËRKON TRYSNI NDËRKOMBËTARE MBI SERBINË PËR TË ZHDUKURIT



Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, familjarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë theksuar se ende janë në pritje të zbardhjes së fatit të mbi 1 600 personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë thënë të martën se Serbisë duhet t'i bëhet presion ndërkombëtar me qëllim që të arrihet marrëveshja për personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë

AKTUALE



PSD-ja ZHVILLON AKSION, MOLLIOAJ: QEVERIA LEGALIZOI DOKUMENTET ILEGALE TË VULOSURA NGA SERBIA F. 5

VUÇIQI: NUK KA SHANS QË ÇËSHËTJA E TARGAVE TË ZGJIDHET PARA 1 SHTATORIT F. 6

AKK-JA: QEVERI, MOS I BLOKO KOMUNAT, ZGJIDHE PROBLEMIN E GREVËS! F. 3

EKONOMI



RAFUNA KËRKON NGA GREQIA LEHTËSIM PËR PAJISJE ME VIZA PËR BIZNESET E KOSOVËS F. 8

KOMUNA E MALISHEVËS SHPËRNDAN MJETET PËR SUBVENCIONIMIN E QUMËSHËTIT F. 8

SPORT



BESA FILLON MBROJTJEN E TITULLIT NË MITROVICË F. 10



DASH-I: MARRËVESHJA PËR DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT, NJË HAP DREJT NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SERBI

FAQE 3



PROTESTOHET NË PRISHTINË KUNDËR DHUNIMIT TË 11 VJEÇES, KËRKOHEM DËNIM ME VDEKJE PËR AUTORËT

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja, gati marrëveshjen e madhe për dërgimin e armëve në Tajvan

WASHINGTON, 30 GUSHT - Marrëdhëniet tashmë të tensionuara midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Kinës janë gati të arrijnë një pikë tjetër të tensionimit. ShBA-ja ka vendosur të dërgojë armë në Tajvan.

Sipas një raporti, qeveria amerikane planifikon të mbështesë Tajvanin me armë në vlerë prej rreth 1.1 miliard dollarë. E përditshmja "Politico", duke cituar tre persona të brendshëm të pidentifikuar, ka shkruar se qeveria amerikane është duke kërkuar nga Kongresi miratimin e një projektligji përkatës. Paketa përfshin 60 raketa kundër anijeve dhe 100 raketa ajër-ajër. Megjithatë, fokusi është në mirëmbajtjen operacionale të sistemeve aktuale ushtarake të



Tajvanit dhe përmbushjen e kërkesave ekzistuese dhe jo në zgjerimin e sistemeve të armatimit, sipas gazetës. Nuk ka ende ndonjë konfirmim zyrtar të të dhënave nga ky artikull. Një dërgesë e tillë armësh ka të

ngjarë të përkeqësuar tensionet tashmë ekzistuese midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës. Marrëdhëniet arrijnë pikën më të ulët pas vizitës së kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi në Tajvan, në fillim të

këtij muaji, duke sfiduar kërcënimet nga Republika Popullore e Kinës.

Pas kësaj vizite Pekini ka nisur manovra ushtarake në shkallë të gjerë rreth ishullit të qeverisur në mënyrë demokratike. Janë bërë stërvitje për një bllokadë detare dhe ajrore në rast pushtimi të mundshëm të Tajvanit. Pavarësisht kësaj, delegacione të tjera me politikanë amerikanë kanë udhëtuar në Tajvan menjëherë pas manovrave. Të dielën javë së kaluar, forcat amerikane kanë lejuar anijet luftarake të kalonin nëpër ngushticën e Tajvanit për herë të parë që nga vizita e Pelosit. Kina ka folur për një "provokim". Republika e Tajvanit është ndarë nga Kina në vitin 1949 pas fitores së komunistëve nën Mao Ce

Dunin në luftën civile. Deri më sot, Pekini e konsideron Tajvanin si një provincë të shkëputur që do të ribashkohet me kontinentin - nëse është e nevojshme duke përdorur edhe forcën ushtarake. Agresioni rus në Ukrainë ka përforcuar këtë frikë.

Ndërsa ShBA-ja e ka njohur udhëheqjen në Pekin si përfaqësuesin e vetëm të Kinës që nga viti 1979 dhe si shumica e vendeve nuk ka marrëdhënie zyrtare me Tajvanin. Megjithatë, ShBA-ja është zotuar me ligj se do të furnizojnë Tajvanin me pajisje ushtarake për të siguruar aftësinë e tij mbrojtëse. Uashingtoni është duke treguar një "paqartësi strategjike" duke mos u përgjigjur qartë nëse ushtria amerikane do të ndërhynte në rast të një pushtimi kinez të Tajvanit./DW/

Gjermania dhe Franca kundërshtojnë ndalesën e vizave për rusët

BERLIN, 30 GUSHT - Një propozim i anëtarëve të Bashkimit Evropian (BE) për të ndaluar vizat turistike për rusët për shkak të luftës në Ukrainë, duket se po përballlet me pengesa të mëdha. Franca dhe Gjermania kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët para takimit të ministrave të BE-së në Pragë, duke thënë se çështja e kufizimit të vizave për rusët do të ishte kundërproduktive, teksa BE-ja po tenton të fitojë "zemrat dhe mendjet" e rusëve që nuk e mbështesin agresionin e paprovokuar të Moskës ndaj Ukrainës.

Çështja e ndalimit të vizave për rusët është aktualizuar ditëve të fundit nga disa shtete të BE-së, por për këtë çështje duhet një vendim unanim i të 27 shteteve anëtare, në mënyrë që të shndërrohet në sanksion të ri kundër Rusisë për shkak të

pushtimit të Ukrainës. "Ne duhet të mendojmë për mënyra të mençura për të përdorur këtë levë të rëndësishme, që është lëshimi i vizave. Përdorimi i kufizimeve kontaktet me përfaqësuesit e regjimit dhe autoritetet në tema të interesit vital të BE-së, ne duhet të luftojmë në mënyrë strategjike për të fituar zemrat dhe mendjet e popullatës ruse - të paktën e atyre segmenteve që nuk janë shkëputur krejtësisht nga Perëndimi", është thënë në deklaratën e përbashkët të Gjermanisë dhe Francës, duke sugjeruar se blloku duhet të vazhdojë të ofrojë viza për studentët, artistët, shkencëtarët dhe profesionistët e tjerë kyç që duan të hyjnë në BE.

Shtetet që ndajnë kufirin me Rusinë, shtetet e Baltikut, Polonia dhe Finlanda janë nismëtare për

vendosjen e kufizimeve sa i përket lëshimit të vizave turistike për rusët. Përdorimi i BE-ja ka vendosur ndalesa në fluturimet nga Rusia, shumica e udhëtarëve përdorin kufijtë tokësorë për të udhëtuar në shtetet e bllokut. Një marrëveshje e vitit 2007, ka mundësuar lehtësimin e kriterëve për marrjen e vizave të BE-së nga rusët, por kjo marrëveshje është pezulluar pjesërisht në fund të shkurtit, duke u pamundësuar udhëtimin në bllok personave të afërt me presidentin rus, Vladimir Putin.

Por, rusët e zakonshëm nuk u preken nga kjo ndalesë dhe ata ende gëzojnë përfitime lehtësuese nga kjo marrëveshje, e cila ul kohën e pritjes dhe të kostos, por edhe kërkon më pak dokumente për aplikim për vizë. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka kërkuar nga BE-ja që të



ndalojë lëshimin e vizave për të gjithë shtetasit rusë, me qëllim që të ndëshkojë Moskën për pushtimin e paprovokuar të shtetit të tij. Por, gjatë një interviste për "Radion Evropa e Lirë", shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, ka thënë më 29 gusht se "veçse ka pasur një pezullim të pjesshëm" sa i përket regjimit të

vizave. "Nuk do të thosha se asnjë rus nuk mund të shkojë kurrë në Evropë, për çfarëdo arsyeje. Por, u takon ministrave të vendosin", ka thënë ai. Borrelli ka thënë se pret të marrë miratimin e ministrave të BE-së që po takohen në Pragë edhe për nisjen e punës në një mision trajnues të ushtrisë ukrainase.

OKB-ja paralajmëron se 6 milionë afganë janë në rrezik nga uria

NYU JORK - Shefi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për ndihmë humanitare, Martin Griffiths u ka bërë thirrje donatorëve që të rinisin financimin e Afganistanit, duke paralajmëruar se 6 milionë afganë janë në rrezik nga uria.

Sipas Griffithsit, mbi gjysma e popullsisë afgane prej 39 milionë banorësh ka nevojë për ndihmë humanitare. "Varfëria po thellohet, popullsia ende po rritet dhe autoritetet de facto nuk kanë buxhet për të investuar për të ardhmen e tyre. Për ne është e qartë se nevojitet që të rikthehet njëfarë mbështetje e zhvillimit", ka thënë Griffithsi në Këshill të Sigurimit të OKB-së.

Talibanët janë rikthyer në pushtet në



gusht të vitit 2021 pasi koalicioni i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara është tërhequr nga vendi dhe qeveria

paraprake afgane ka kolapsuar shumë shpejt pas kësaj. Komuniteti ndërkombëtar nuk ka njohur

qeverinë e talibanëve, e cila është duke shtypur, veçanërisht të drejtat e grave.

Qëkur talibanët kanë marrë pushtetin, ndihma ndërkombëtare që përbënte 80 për qind të buxhetit të Afganistanit është ndaluar.

Talibanët janë subjekt të sanksioneve ndërkombëtare, që sipas OKB-së dhe grupeve të ndihmës tani po pengojnë operacionet humanitare në Afganistan. "Autoritetet de facto të Afganistanit duhet të bëjnë pjesën e tyre. Ndërhyrjet burokratike dhe procedurat ngadalësojnë ndihmën humanitare, e cila është e nevojshme. Punëtorët e ndihmës humanitare... duhet të lejohen të punojnë të papenguar. Dhe vajzat

duhet të lejohen të vazhdojnë edukimin e tyre", ka thënë Griffithsi. Pavarësisht sfidave, ai ka thënë se agjencitë e OKB-së dhe organizatat partnere kanë pasur "një përgjigje të paprecedent" gjatë vitit të fundit, duke ndihmuar pothuajse 23 milionë banorë.

Zyrtari i OKB-së ka thënë se duhen urgjentisht 614 milionë dollarë për t'u përgatitur për dimër, përfshirë edhe për riparimin e strehimoreve dhe ofrimin e rrobave dhe batanijeve të ngrohta. Sipas Griffithsit, edhe 154 milionë dollarë shtesë nevojiten për furnizim me ushqim dhe gjëra të tjera, para se moti i keq të pamundësojë qasjen në disa zona të caktuara.

Sindikalistët: Qeveria ta zgjedhë dialogun e jo shantazhet e kërcënimeve

PRISHTINË, 30 GUSHT - Greva e sindikalistëve në Kosovë do të vazhdojë deri në realizimin e kërkesave, thanë në një konferencë për medie të martën përfaqësuesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK). Ata i bënë thirrje Qeverisë së Kosovës ta zgjedhë dialogun e jo siç thanë "shantazhet e kërcënimeve".

Rrahman Jashari, i cili është edhe kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit në Kosovë, ka thënë se Qeveria e Kosovës po tenton ta ngufatë zërin e grevistëve, teksa shtoi se janë duke u konsultuar me ekipet ligjore për mundësinë e ngritjes së padisë ndaj ministrit të Financave, Hekuran Murati. Ky koment i Jasharit vjen një ditë pasi ministri Murati ka thënë se punëtorët e sektorit publik, të cilët janë në grevë nga 25 gushti, nuk do ta marrin pagën e plotë nga Qeveria e Kosovës. "Për 5 ditë punë i bie rreth 90 euro minus këtë muaj [në pagë]", ka thënë Murati më 29 gusht në një konferencë për medie.

Por, sindikalistët thanë se qeveria

e ka për obligim t'i paguajë pagat e punëtorëve gjatë grevës.

Jashari ka thënë se greva mund të ndalet nëse qeveria i plotëson kërkesat e tyre dhe sërish i bëri thirrje ekzekutivit që të takohet me përfaqësuesit e sindikalistëve për të gjetur një zgjidhje. "Kërcënimi i tij [v.j. Hekuran Murati] ka pasur për synim ta frikësojë dikë dhe të ngufatë vullnetin dhe zërin e grevistëve që janë dhe do të jenë në grevë derisa nuk zgjidhen kërkesat e tyre legjitime", ka thënë Jashari.

Që nga 25 gushti, në grevë janë mësimdhënësit, edukatorët në kopshtet publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës.

Kërkesa kyçe e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e nga 100 eurove për punëtorët, derisa të hyjë në fuqi Projektligji për pagat.

Jashari ka thënë se nisja e vitit të ri shkollor më 1 shtator do t'i gjejë "nxënësit në shtëpi, e mësimdhënësit në grevë", nëse nuk plotësohen kërkesat e tyre.



Së fundmi, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka hartuar Projektligjin për pagat.

Ky projektligj duhet të kalojë në procedurat e konsultimeve paraprake e publike dhe, pas

miratimit në Qeveri e Kuvend, të publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

DASH: Marrëveshja për dokumentet e identifikimit, një hap drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 30 GUSHT - Shtetet e Bashkuara mbështesin marrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë për dokumentet e identifikimit, tha një zëdhënës i Departamentit të Shtetit të hënën. Sipas tij, Shtetet e Bashkuara "e shohin marrëveshjen si një hap të rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve, të bazuar në njohjen reciproke".

Marrëveshja e arritur të shtunën pasoi pas një periudhe përpjekjesh diplomatike amerikane dhe evropiane për t'i shmangur tensionet në terren që shpërthyen më 31 korrik pas reagimeve serbe ndaj vendimit të qeverisë në Prishtinë që

dokumentet e identifikimit dhe targat e makinave të lëshuara nga Serbia, të mos vlejnin në territorin e Kosovës, një veprim që zbatohet nga Beogradi për qytetarët e Kosovës që udhëtonin nëpër Serbi në dhjetë vjetet e fundit. "Arritja e zgjidhjes përmes dialogut është kritike për të dyja vendet në rrugën e tyre drejt integritimit evropian, thuhet në përgjigjen e zëdhënësit të Departamentit të Shtetit për "Zërin e Amerikës".

Shefi i Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha të shtunën se "Serbia kishte rënë dakord t'i shfuqizonte dokumentet hyrëse/dalëse për bartësit e dokumenteve të

identifikimit të Kosovës dhe Kosova u pajtua që të mos i zbatojë ato për qytetarët nga Serbia".

Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit tha se "bazuar në angazhimet e të dyja palëve dhe punën e palodhur të përfaqësuesit të posaçëm të Bashkimit Evropian, ne i inkurajojmë Serbinë dhe Kosovën që të marrin një rol aktiv dhe të ecin përpara në mënyrë paqësore".

Zyrtarët amerikanë dhe ata evropianë shpresojnë që Kosova dhe Serbia të kenë një qasje konstruktive për gjetjen e një zgjidhjeje edhe për çështjen e targave të makinave.

AKK-ja: Qeveri, mos i blloko komunat, zgjidhe problemin e grevës

PRISHTINË, 30 GUSHT - Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ka kërkuar që problemi rreth grevës në arsim dhe administratë të zgjidhet në nivel nacional sepse, sipas këtij bordi, ky problem është nacional e jo lokal. "Zgjidhja e këtij problemi nuk mund të bëhet nëpër komuna veç e veç. Bordi i AKK-së kërkon që sa më parë palët e involuara në këtë çështje të fillojnë dialogun në mënyrë që të mos pësojnë nxënësit dhe qytetarët duke mos pranuar shërbime nëpër komuna e në veçanti tash kur është urgjente legalizimi i

objekteve pa leje sepse afati përfundon më 4 shtator, si dhe shërbimet urgjente ndaj diasporës tonë të nderuar e që iu nevojiten për udhëtim. Bordi i AKK-së konsideron që kompetencat sa i përket punëtorëve arsimor (parauniversitar) u takojnë komunave dhe për këtë arsye kërkojnë që presioni i Qeverisë për të marrë listën e punëtorëve grevist përmes shkresave dhe inspektorëve të arsimit është jashtë çdo norme dhe logjike", është thënë në reagimin e AKK-së.

Ky bord ka theksuar se

komunat i kanë kompetencat e tyre vetjake të dhëna në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale. "Qeveri mos bëni presion mbi zyrtarët komunalë për sigurimin e listave të punëtorëve grevist. Kompetencat që burojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale janë duke u ushtruar edhe në këtë çështje. AKK-ja edhe njëherë i bënë thirrje qeverisë që urgjentisht të ulet e të bisedojë me sindikatat përkatëse, në mënyrë që mos të pësojnë edhe më tutje nxënësit dhe qytetarët", është theksuar në reagimin e AKK-së.





KOSOVA SHËNON DITËN NDËRKOMBËTARE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR

Kosova kërkon trysni ndërkombëtare mbi Serbinë për të zhdukurit

Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdurve, familjarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë theksuar se ende janë në pritje të zbardhjes së fatit të mbi 1 600 personave të zhdurur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë thënë të martën se Serbisë duhet t'i bëhet presion ndërkombëtar me qëllim që të arrihet marrëveshja për personat e zhdurur me dhunë gjatë luftës në Kosovë

qëllim që të arrihet marrëveshja për personat e zhdurur me dhunë gjatë luftës në Kosovë. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se dënojnë çdo ditë me veprimtarinë e tyre institucionale

dhe me qëndrimet shtetërore, gjenocidin e Serbisë në Kosovë. "E një ndër shprehjet më të egra, më të dhimbshme, që na ka shkaktuar shumë vuajtje, humbje e ankth, të gjenocidit të Serbisë në Kosovë,

janë të pagjeturit, të zhdurur me dhunë, që vazhdojnë të ngelen një plagë e hapur për shtetin tonë dhe shoqërinë tonë", ka pohuar kryeministri Kurti, duke theksuar se si institucione kanë përgjegjësi

EULEX-i thotë se po punon për gjetjen dhe kthimin e mbetjeve mortore të personave të zhdurur

Në Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdurur me Dhunë, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka theksuar se qëndron pranë familjarëve të personave të zhdurur të Kosovës të cilët janë viktimat të këtij krimi mizor dhe kanë të drejtë të dinë të vërtetën rreth fatit të më të dashurve të tyre. "Që nga fillimi i mandatit e deri më sot, EULEX-i ka punuar pareshur për gjetjen dhe kthimin e mbetjeve mortore të personave të zhdurur tek familjet e tyre për një varrim të respektuar dhe dinjitoz. Ndrërimi i fatit të personave të zhdurur është detyrë e vazhdueshme; që nga viti 2009, Misioni ka kryer gjithsej 692 operacione në terren për gjetjen e personave të zhdurur, që përfshijnë 188 zhvarrime. Mbetjet mortore të 480 individëve janë identifikuar, përfshirë 332 persona të zhdurur.



Gjatë periudhës gusht 2021 - gusht 2022, ekspertët e EULEX-it morën pjesë në 21 operacione në terren, që kanë përfshirë nëntë zhvarrime. Kjo ka rezultuar në identifikimin e tre personave të zhdurur. Aktualisht ekspertët e

EULEX-it janë po ashtu duke punuar me autoritetet e Kosovës për rishikimin e të gjitha mbetjeve mortore njerëzore që janë të ruajtura në morgun e Prishtinës, si dhe të dosjeve të ndërlidhura", ka njoftuar EULEX-i.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 30 gusht - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, së bashku me kryeministrin Albin Kurti, ministrin, deputetë, korin diplomatik, dhe me familjarë të të zhdurur me dhunë nga lufta e fundit në Kosovë, kanë bërë homazhe të martën tek obelisku për personat e pagjetur, me rastin e 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdurur. Presidentja Osmani ka thënë se "ata janë dhimbja dhe kujtesa jonë kolektive. Ata janë dëshmia e përpjekjes së regjimit gjenocidal serb për shfarosjen tonë. Mbi të gjitha, ata janë pengu i lirisë sonë, ndaj zbardhja e fatit të tyre është përkushtim i çdoditshëm". Sipas presidentes Osmani, paqe të qëndrueshme nuk mund të ketë pa zbardhjen e fatit të të

zhdurur me dhunë në luftën e fundit në Kosovë. "Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdurve, familjarët, sikurse edhe e gjithë Kosova, ende është në pritje të zbardhjes së fatit të mbi 1 600 personave të zhdurur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ata janë dhimbja dhe kujtesa jonë kolektive. Ata janë dëshmia e përpjekjes së regjimit gjenocidal serb për shfarosjen tonë. Mbi të gjitha, ata janë pengu i lirisë sonë, ndaj zbardhja e fatit të tyre është përkushtim i çdoditshëm. Paqe të qëndrueshme nuk mund të ketë pa zbardhjen e fatit të të zhdurur me dhunë në luftën e fundit në Kosovë. Jemi të përkushtuar e të vendosur që fati i tyre të zbardhet, e vërteta të ngadhënjëjë dhe drejtësia të triumfojë", ka deklaruar Osmani, duke shtuar se Serbisë duhet t'i bëhet presion ndërkombëtar me

PSD-ja zhvillon aksion, Molliqaj: Qeveria legalizoi dokumentet ilegale të vulosura nga Serbia

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 GUSHT - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka folur për marrëveshjen e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë për të cilën ka thënë se qeveria aktuale i legalizoi dokumentet ilegale të vulosura nga Serbia. Përmes një aksioni të cilën e mbajtën të martën para objektit të Qeverisë së Kosovës, Molliqaj ka thënë se letërnjoftimet në fjalë e trajtojnë Kosovën si pjesë të brendshme të Serbisë. “Iku pa u komentuar, pa u dalluar, pika që e bëri të pranueshme për Vuçiqin

marrëveshjen për dokumentet e identifikimit (ID). Problemi fillon kur kjo pikë bëhet pozicion zyrtar edhe i shtetit tonë. Kjo qeveri legalizoi dokumentet ilegale të vulosura nga Serbia. Letërnjoftimet në fjalë e trajtojnë Kosovën si pjesë të brendshme të Serbisë. A nuk është ky cenim dhe degradim?”, ka thënë Molliqaj para medieve. Sipas tij, në fund të ditës këto marrëveshje të pjesshme njëzohen tek Asociacioni etnik. “Prej deklaratave që nuk do të diskutohet për çështje të brendshme të Kosovës e deri te pozicioni që njeh dokumentet

ilegale është kapërcim i madh. Zhvillim dramatik! Deklarata publike nga Kurti, Bislimi dhe Konjufca se nuk bëhet fjalë për Asociacion, kur bisedohet me Serbinë, i mori uji. Pozicioni i Kosovës kundër Asociacionit po tretet. Mbase kurrë nuk paska qenë. Dhe kreu kjo në emër të normalizimit të marrëdhënieve. Por çka po normalizohet? Ky term nuk është neutral. Në këtë situatën po normalizohet mosnjohja, po përjetësohet tensioni dhe po ruhet konflikti”, ka thënë ai, duke shtuar se zhurma e festës së propagandës nuk mund as t'i kompensojë, as t'i fshehtë humbjet.



të bëjnë gjithçka që munden dhe dinë, që sa më parë të zbardhet fati i atyre 1 617 të pagjeturve. “Njëkohësisht me faktorët ndërkombëtarë të bëjmë trysni, që në Beograd të hapen arkivat dhe asisoj të merret vesh e vërteta për më të dashurit tanë”, ka deklaruar ai.

Përveçse duhet të hapen arkivat, kryeministri ka theksuar se në të njëjtën kohë edhe prokuroria te ne duhet të jetë shumë më aktive, gjyqësori shumë më efikas sepse, sipas tij, deri tek e vërteta arrihet edhe nëpërmjet drejtësisë, nëpërmjet kërkimit të përgjegjësive prej atyre, të cilët i vranë, i varrosën, i zhvarrosën, i dërguan në Serbi, i varrosën atje dhe më pas u zhvarrosën nëpër ato pesë varreza masive që, mbase, ka edhe më shumë se aq. “950 shqiptarë janë zhvarrosur prej varrezave masive të Batajnicës, Kizhevakut, Rudnicës, Bajnabashës dhe Petrovosellos e Peruçacit”, është shprehur Kurti. Ai ka theksuar angazhimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbardhjen e së vërtetës për 1 617 persona për fatin e të cilëve nuk dihet. “Në mesin e këtyre 1 617 të zhdukurve me dhunë, shumica janë shqiptarë, por ka edhe që nuk janë shqiptarë, dhe ne angazhohemi për zbardhjen e fatit të të gjithëve pa dallim etnie”, ka thënë Kurti.

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se mbeten të përkushtuar për të kërkuar dhe gjetur të vërtetën për personat e zhdukur. “Ne qëndrojmë me çdo person që është në pritje të lajmeve për të dashurit e tyre të

zhdukur dhe mbetemi të përkushtuar për të kërkuar dhe gjetur të vërtetën”, ka deklaruar Hovenier.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se në Ditën Ndërkombëtare të Personave të

treguar për fatin e qytetarëve të Kosovës që janë zhdukur me dhunë, duke refuzuar ta përmbushë këtë obligim legal, para së gjithash human. E drejta ndërkombëtare humanitare e kërkon këtë, Kosova e kërkon këtë,

familjet e personave të zhdukur në vendin tonë e presin këtë”, ka thënë Krasniqi.

E lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se zemra e tij bashkëndien me familjarët që ende presin të dashurit e tyre, si sot, kur

bota kujton personat e zhdukur, ashtu edhe çdo ditë e gjithmonë, derisa të vendoset drejtësia. “Ata mbesin plagë e hapur e shoqërisë sonë, i rrëmbyen vetëm pse deshën të jetojnë të lirë në dheun e të parëve”, ka theksuar Haradinaj.



Zhdukur qëndrojnë pranë familjeve që akoma presin një lajm për më të dashurit e tyre. “Fatkeqësisht, Serbia, si shkaktare e zhdukjes së tyre, akoma nuk ka

Kurti viziton shtëpinë muze të familjes Qerkezi

Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur me dhunë, kryeministri Albin Kurti së bashku me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, vizituan shtëpinë muze të familjes Qerkezi. Aty u pritën nga Ferdonije Qerkezi, Nesrete Kumnova dhe përfaqësueset e organizatës “Thirrjet e Nënave”.

Kurti ritheksoi se Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për ndriçimin e fatit të të zhdukurve me dhunë gjatë luftës, për t'i dhënë fund ankthit të pritjes së

familjarëve. “Baca Halim, Artani, Armendi, Ardiani dhe Edmondi janë emra që i njohim të gjithë dhe i mbajmë në zemër. Janë emra të vuajtjes e dhimbjes, të humbjes e pikëllimit, jo vetëm të Nënës Ferdonije, por të gjithë popullit dhe secilit qytetar”, ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka thënë se qëndresa e nënës Ferdonije na mban të fortë të gjithëve, na inkurajon e na frymëzon.

Gjatë kësaj vizite u rikujtua edhe protesta e para 18 viteve për

zbardhjen e fatit të të zhdukurve, gjatë së cilës kryeministri Kurti, atë kohë si protestues, u arrestua bashkë me përfaqësueset e organizatës “Thirrjet e Nënave”. Duke i falënderuar për qëndresën e tyre, kryeministri shprehu mirënjohje për angazhimin e nënave nga Gjakova, të cilat protestonin edhe për lirimin e të burgosurve nga burgjet serbe dhe që vazhdojnë aktivizmin e tyre, për zbardhjen e fatit dhe të vërtetës për personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë.



Vuçiçi: Nuk ka shans që çështja e targave të zgjidhet para 1 shtatorit

PRISHTINË, 30 GUSHT - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, ka thënë se nuk sheh mundësi që çështja e targave me Kosovën të zgjidhet para 1 shtatorit. Ai shtoi se beson se Kosova me shumë gjasë do ta nisë fushatën për reregjistrimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia. "Nuk mendoj se do të ketë shumë sukses në këtë çështje. Edhe pse kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha në Bruksel se do të jetë i suksesshëm dhe se serbët do të jenë të interesuar që t'i ndryshojnë targat. Le të shohim. Është një proces që do të zgjasë. Nuk ka asnjë shans që kjo çështje të zgjidhet para 1 shtatorit", ka deklaruar Vuçiçi të martën.

Pas ndërmjetësimit të përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, më 27 gusht Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për çështjen e dokumenteve të identitetit. Megjithatë, vendimi i Prishtinës për reregjistrimin e makinave që përdorin targa të lëshuara nga Serbia pritet të hyjë në fuqi më 1 shtator.

Sikurse vendimi i dokumenteve për hyrje-dalje, edhe ai për targat u kundërshtuan nga serbët lokalë, të cilët ngritën barrikada në veri të Kosovës. Vlerësohet se 10 000 targa me akronime të qyteteve të Kosovës sikurse PZ, KM, PR, UR e të ngjashme qarkullojnë në veriun e banuar me shumicë serbe.

Qeveria e Kosovës ka argumentuar se qytetarët do të kenë afat prej dy muajsh për t'i reregjistruar makinat në targa RKS - Republika e Kosovës. Serbia ka propozuar që serbët në veri të pajisen me targa KS që kanë status neutral ndaj shtetësisë së Kosovës, por Kurti e ka hedhur poshtë këtë propozim.

Vuçiçi ka theksuar se mbetet të shihet nëse do të ketë ndonjë ndryshim pas samitit të vendeve të Ballkanit dhe vizitës së presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan dhe disa përfaqësuesve të tjerë evropianë, por shtoi se atij i duket se aktualisht nuk ka mundësi për përparim. "Nuk ka dëshirë në Prishtinë për t'u



diskutuar për zgjidhje racionale dhe zgjidhje kompromisi. Ndoshta jam vetëm unë! Ndoshta evropianët e dinë më mirë!", ka thënë ai.

Vuçiçi shtoi se Serbia është "gjithmonë në anën e së drejtës ndërkombëtare në të gjitha

rastet dhe mosmarrëveshjet ndërkombëtare". Ai tha se e vetmja politikë zyrtare e Beogradit është respektimi i Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha rezolutat ndërkombëtare. Ndërkaq, shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep

Borrell, gjatë një interviste për Radion Evropë e Lirë deklaroi më 29 gusht se çështja e targave është më e vështira për t'u zgjidhur. Megjithatë, ai shtoi se mbetet "optimist" sa i përket mundësisë së zgjidhjes së këtij problemi.

Ministri Çeku përfaqësoi Kosovën në Samitin Ndërkombëtar të Kulturës në Edinburg të Skocisë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Samiti i Kulturës, që këtë vit shënoi edicionin e gjashtë, është ngjarja dyvjetore që i bën bashkë ministrat e kulturës, institucionet e artit dhe artistët nga e gjithë bota.

Delegacioni i Kosovës mori pjesë në këtë samit me ftesë të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, Qeverisë së Skocisë, Këshillit Britanik (British Council) dhe Parlamentit të Skocisë, bashkë-organizatorë të ngjarjes.

Gjatë samitit panelistët dhe delegatët pjesëmarrës, nga kryeministri britanik Boris Johnson, te ministrat e kulturës nga shumë shtete e deri tek artistët, aktivistët e zyrtarët e tjerë, diskutuan për rolin që kanë arti e kultura në edukim, liri, paqe dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Ky organizim vjen edhe si thirrje globale për ta rimenduar politikën kulturore, si përpjekje për ta nxjerrë trajtimin e kulturës nga qasja sektorale dhe vendosur atë në thelb të tërë spektrit qeverisës, politikave publike dhe planifikimit zhvillimor.



Përgjatë tri ditëve ministri Çeku bashkë me ekipin e tij ishin pjesë e sesioneve dhe paneleve si folës, patën takime bilaterale me delegacione të ndryshme shtetërore dhe ndoqën disa aktivitete

kulturore në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Edinburgut. Në fjalimin e mbajtur para të pranishmëve, ministri Çeku ofroi hollësi mbi reformën ligjore dhe institucionale në art

dhe kulturë në Republikën e Kosovës. Duke folur për vizionin e qeverisë për zhvillimin kulturor, ai sqaroi se ripërcaktimi i politikës kulturorë synon institucione efikase dhe të pavarura, rritje të

audiencave, shpërndarje më efektive të fondeve dhe prezantim ndërkombëtar të shtetit.

Ministri Çeku në veçanti potencoi ndikimin që kultura ka në sistemin arsimor, duke paralajmëruar nisjen e programit shtetëror për edukim artistik. Ai, gjithashtu, tregoi për përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për ta ndërlidhur artin, kulturën e trashëgiminë kulturore me sferat e tjera të politikave publike, si planifikimin hapësinor e mjedisin, zhvillimin ekonomik, shëndetësinë, arsimin e diplomacinë.

Delegacioni i Kosovës pati disa takime dhe shkëmbime me ministrat, zëvendësministrat, sekretarët shtetërorë të kulturës nga Mbretëria e Bashkuar, Katari, Letonia, Uells, Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara (National Endowment for the Arts). Këto takime shërbyen për ta nisur dialogun për bashkëpunimin e ardhshëm bilateral kulturor ose për konsolidimin e marrëdhënieve ekzistuese në kulturë.

1 391 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 559 testimeve,

janë konfirmuar 91 raste të reja me Covid. Nuk ka pasur persona të vdekur nga ky virus në 24 orët

e fundit. Sipas njoftimit të MSh-së, 203 persona janë shëruar, ndërkaq raste aktive me Covid

janë 1 391. Në 24 orët e fundit 46 qytetarë kanë marrë vaksinën kundër Covidit.



Protestohet në Prishtinë kundër dhunimit të 11 vjeçes, kërkohet dënim me vdekje për autorët

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 30 GUSHT - Dhjetëra qytetarë janë mbledhur të martën para Teatrit Kombëtar të Kosovës në Prishtinë për të protestuar për rastin e dhunimit të një 11 vjeçeje në Prishtinë. Në këtë reagim qytetar nuk morën pjesë ndonjë prej figurave të njohura publike apo krerët e institucioneve shtetërore.

Aktivistja Xheraldina Rexhepi, duke e quajtur ngjarjen makabre, u shpreh se këto ngjarje tregojnë se shoqëria ka dështuar. Duke shprehur bindjen se do të ketë reagim institucional ndaj personave të dyshuar, ajo tha se nuk po bëhet asgjë në drejtim të parandalimit të këtyre dukurive.

Nga Ferizaj për të marrë pjesë në këtë protestë kishte ardhur edhe Shukri Retkoceri, i cili kërkoi nga krerët e shtetit të reagojnë karshi dukurive të dhunimit. "Unë i lus Vjosa

Osmanin, Albin Kurtin, Albulena Haxhiun le t'i hulumtojnë pak prokurorët dhe gjyqtarët a po e kryejnë punën, a po i kryejnë detyrat sipas ligjit sipas Kushtetutës së Kosovës. Ky akt kriminal që ka ndodhur, ata dhunues e meritojnë varjen këtu përpara bustit të Skënderbeut dhe më kurrë këso raste nuk ndodhin", u shpreh Retkoceri.

Ai kërkoi hetim për prokurorët dhe gjyqtarët që merren me këto raste.

Ndërkaq Lulzim Bexheti ka kërkuar nga qeveria që përmes edukimit të hershëm të parandalohen këto raste. Ai iu bashkua kauzës që emrat e personave që tashmë dyshohen për dhunim të 11 vjeçes të bëhen publik.

Dhunimi i të miturës ngjalli reagime të shumta në shoqërinë tonë. Aktualisht deri tani janë arrestuar të gjithë personat e dyshuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar të martën se dy të dyshuarve për dhunimin e 11



vjeçes u është caktuar masa nga një muaj paraburgim.

Gjatë së hënës masë me kohëzgjatje të njëjtë paraburgimi u është caktuar edhe tre të dyshuarve të tjerë.

Aktualisht në paraburgim janë pesë të dyshuarit për dhunimin e të miturës.

Një 11-vjeçare dyshohet se është dhunuar nga pesë

persona më 27 gusht, në Prishtinë, ka njoftuar të hënën Policia e Kosovës. Sipas PK-së, viktima është dërguar në një strehimore.

Rasti dyshohet se ka ndodhur në një park të qytetit.

Të dyshuarit për dhunimin e 11 vjeçes janë tre të mitur me inicialet G. R., G. J. dhe Xh. S. si dhe personi i katërt i moshës

madhore, me inicialet E. R. Rasti nxiti reagime të shumta si nga udhëheqësit e institucioneve, po ashtu edhe nga përdorues të tjerë të rrjeteve sociale.

Qytetarë dhe organizata të ndryshme joqeveritare kanë paralajmëruar protesta në Prishtinë për të martën dhe të mërkurën.

KOMF-i: Vetëm vitin e kaluar janë shënuar 249 raste kundër integritetit seksual të fëmijëve

PRISHTINË, 30 GUSHT - Nisur nga rasti i fundit i dhunimit seksual të të miturës 11 vjeçe, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF, i cili përfaqëson 34 organizata joqeveritare, ka mbajtur konferencë për medie, ku ka shprehur shqetësimin e thellë karshi neglizhimit, mosveprimit të institucioneve dhe performancës së dobët të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në parandalimin e situatave të sulmeve dhe abuzimeve seksuale ndaj fëmijëve dhe trajtimin e rasteve ku fëmijët janë viktima të abuzimit seksual.

KOMF ka shprehur indinjatën e thellë lidhur me krijimin e kulturës së mosndëshkimit të kryerësve të veprave të krimeve seksuale kundrejt fëmijëve, të



kultivuar në radhë të parë nga vetë institucionet e mandatuara për mbrojtjen e fëmijëve. "Kjo kulturë ka stimuluar një mjedis social të pasigurt e të rrezikshëm, ku

shkelja e të drejtave themelore të fëmijëve, cenimi i integritetit të tyre fizik, moral dhe seksual, bëhet fenomen i zakonshëm e jo përjashtim", është thënë nga përfaqësuesit e KOMF-it.

Sipas KOMF-it, vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të veprave kundër integritetit seksual të fëmijëve sikurse dhunimi, sulmi seksual, degradimi i integritetit seksual dhe keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi.

Përkatesisht, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, në vitin 2021 janë shënuar 249 raste kundër integritetit seksual të fëmijëve. "Rastet e abuzimeve seksuale të fëmijëve dëshmojnë dhimbshëm jo vetëm ngathtësinë dhe mepshtësinë e sistemit të mbrojtjes së fëmijës viktimë e abuzimit seksual, por edhe mungesë të theksuar të seriozitetit të gjithë sistemit të drejtësisë, në trajtimin dhe ndëshkimin e kryerësve të

abuzimit seksual me fëmijët. Marrë parasysh rastet e shumta që janë raportuar dhe bërë mediatike së fundmi, përfshirë këtu edhe rastet që kanë përfunduar me fatalitet pikërisht për shkak të dështimit të institucioneve të sistemit prokurorial dhe gjyqësor, ne kemi pritur reagim institucional nga niveli më i lartë, me qëllim reflektimi, mobilizimi dhe llogaridhënieje për mungesë performancë në nivel të përgjegjësisë, të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes së fëmijës. Mosveprimi perceptohet si indiferencë e kjo reflekton negativisht tek ofruesit e mbrojtjes në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe përgjegjësisë", kanë theksuar përfaqësuesit e KOMF-it.

Osmani udhëton për në Çeki

PRISHTINË, 30 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar zyrtarisht për në Çeki. Atje ajo do të zhvillojë një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë të Çekisë si dhe do të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të Forumit 2000, së bashku me liderë të tjerë botërorë.

Çekia aktualisht udhëheq Presidenten e Këshillit të Bashkimit Evropian, prandaj në këto takime presidentja Osmani do ta adresojë në

veçanti çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën dhe avancimin e agjendës evropiane të vendit tonë.

Osmani, ndër të tjera, do të takohet me kryeministrin çek Petr Fiala, me presidentin e senatit çek, Milos Vystrel si dhe me zëvendëskryeministrin, njëherësh ministër për Punë të Jashtme të Holandës, Wopke Hoekstra.

Në kuadër të kësaj vizite, presidentja Osmani do të marrë pjesë dhe do të flasë në konferencën ndërkombëtare të

Forumit 2000 me temë: Rreziku i qartë dhe i tashëm i demokracisë: si të përgjigjemi. Fondacioni Forum 2000 vazhdon trashëgiminë e ish-presidentit çek Vaclav Havel në mbështetje të vlerave demokratike, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe duke ndihmuar në zhvillimin e shoqërisë civile dhe inkurajuar tolerancën kulturore dhe etnike. Presidentja Osmani në këtë konferencë do të mbajë dy fjalime si dhe do të marrë pjesë edhe në disa aktivitete të tjera.



Dalja jashtë funksionit të bllokut A3, KEK: Inspektimi pritet të përfundojë në fund të muajit

PRISHTINË, 30 GUSHT - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se inspektimi i bllokut A3 të termocentralit "Kosova A" pritet të përfundojë më 31 gusht. Sipas KEK-ut, menjëherë do të fillojë sanimi i kësaj njësie për kthim në funksion.

"Korporata Energjetike e Kosovës njofton se konform procedurave dhe praktikave inspektimi i njësisë A3 pritet të përfundojë më 31 gusht 2022 dhe menjëherë do të fillojë sanimi i kësaj njësie për kthim në punë", ka njoftuar KEK-u.

Kjo korporatë ka njoftuar se është siguruar një sasi e energjisë për ta zëvendësuar mungesën e prodhimit nga A3. "Përkundër mungesës së madhe të energjisë në treg, [për sot] kemi arritur të sigurojmë rreth 70 për qind të energjisë si zëvendësim të mungesës së prodhimit të planifikuar të njësisë A3", ka

njoftuar KEK-u.

Ndërkaq, KEDS-i kishte njoftuar se do të ketë përkeqësim të situatës energjike në vend, pasi njësisë A3 ka dalë nga funksioni. Sipas tyre, në vend aktualisht po prodhohen më pak se 400 megavatë rrymë.

"Aktualisht kufizimet janë dyorëshe, por që të mos përkeqësohet tutje situata, kërkojmë nga të gjithë konsumatorët kursim maksimal të energjisë elektrike. Përdorimi i saj në mënyrë eficiente bën që të gjithë të kemi energji elektrike më tepër. Në këto rrethana të vështira duhet të veprojmë të bashkuar në mënyrë që t'i kapërcejmë ato sa më lehtë. Së bashku mund t'ia dalim", thuhej në njoftimin e KEDS-it. Nga 15 gushti KEDS-i kishte filluar reduktimet e energjisë elektrike me nga 2 orë në ditë për çdo 6 orë. Në fillim të këtij



muaji, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar vendimin e qeverisë për vendosjen e masave emergjente në furnizimin me energji

elektrike. Sipas arsytimit, ky vendim është marrë nga gjendja aktuale botërore energjetike. Këto masa do të mbesin aktive për 60 ditë.

Kujtojmë se në fund të vitit të kaluar qeveria kishte marrë vendim për shpalljen e gjendjes emergjente me energji elektrike.

Rafuna kërkon nga Greqia lehtësim për pajisje me viza për bizneset e Kosovës



PRISHTINË, 30 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur në takim shëfën e zyrës ndërlidhëse të Greqisë, ambasadorën Heleni Vakali, si dhe konsullin në këtë zyrë, Michail Verttakis, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin ekonomik në mes dy vendeve, me theks të veçantë në mundësitë për të thelluar këtë bashkëpunim dhe krijimin e lehtësirave për afaristët e Kosovës.

Rafuna u shpreh se Greqia është partnere e rëndësishme e Kosovës dhe se ekonomitë e të dyja vendeve duhet ta thellojnë edhe më tutje bashkëpunimin në mes tyre. "Kosova dhe Greqia tanimë kanë vënë themelet e një bashkëpunimi ekonomik të mirë në mes vete dhe nga kjo kanë përfituar të dyja vendet. Tani duhet të punohet që ky

bashkëpunim të thellohet në sektorët ku ka bashkëpunim, por edhe të zgjerohet në më shumë sektorë të rinj", u shpreh Rafuna, duke shprehur falënderim për zotimin e zyrës ndërlidhëse greke që të aplikojë lehtësira për pajisjen me viza të bizneseve që janë anëtare të Odës Ekonomike të Kosovës. "Vizat janë ndër pengesat kryesore të bizneseve të Kosovës. Çdo lehtësi për t'u pajisur me viza për biznes për anëtarët e Odës Ekonomike të Kosovës është përkrahje për ekonominë kosovare në përgjithësi", u shpreh Rafuna. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës ka propozuar edhe mbajtjen e takimeve B2B ndërmjet bizneseve greke dhe atyre kosovare si dhe angazhimin në përpjekjet për eliminim të barrierave ekonomike në mes të dyja vendeve.

Komuna e Malishevës shpërndan mjetet për subvencionimin e qumështit

MALISHEVË, 30 GUSHT - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sylë Dukolli, kanë vizituar njëri nga pikat e grumbullimit të qumështit dhe i kanë njoftuar fermerët, se janë shpërndarë mjetet për subvencionimin e qumështit prej 3 centësh për çdo litër qumësht të dorëzuar.

Po ashtu, kryetari Kastrati i ka njoftuar fermerët se i kanë filluar procedurat edhe për furnizimin e tyre me bidon për qumësht, me qëllim të ruajtjes së cilësisë së qumështit. "Ashtu siç kemi

premtuar, gjatë javës së kaluar i kemi ekzekutuar mjetet për subvencionimin e qumështit për gjashtëmujorin e parë, nga 3 centë për çdo litër qumësht të dorëzuar. Po ashtu, ju njoftoj se i kemi filluar edhe procedurat për furnizim me bidon për qumësht me qëllim që të lehtësohet puna juaj për ruajtjen e cilësisë së qumështit. Premtoj se do të vazhdojmë përkrahjen në të gjitha fushat e bujqësisë", ka thënë Kastrati gjatë vizitës në pikën e grumbullimit të qumështit në Tërpezë të Poshtme, te fermeri Sami Krasniqi.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sylë Dukolli, ka bërë me dije se janë ekzekutuar mjetet për subvencionim të qumështit në vlerë prej 30 mijë eurosh për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për mbi 80 fermerë të komunës së Malishevës, të cilët e dorëzojnë qumështin në pikat grumbulluese dhe kjo përkrahje për qumësht, por edhe në fushat e tjera të bujqësisë, do të vazhdojë. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se janë duke punuar që në vitin tjetër të rritet përkrahja në bujqësi.



Pse e braktisa Facebook-un dhe Instagram-in, dhe pse nuk do të rikthehem më kurrë



Nga Charlotte GRAINGER

Në dhjetorin e vitit 2017, vetë studiuesit e Facebook vunë publikisht në dyshim nëse faqja mund të ishte potencialisht një kërcënim për shëndetin mendor të publikut. Tashmë kisha disa muaj që mendoja nëse do të hiqja dorë apo jo prej kësaj platforme. Por ky lajm ishte vendimtar për mua. I braktisa rrjetet sociale.

Dhe arsyeja ishte shumë e thjeshtë. Vitet e fundit, ka pasur shumë studime, se si një shkëputje nga mediat sociale të përmirëson ndjeshëm mirëqenien tuaj. Unë i lexoja me durim dhe mbaja shënim secilën prej tyre që e hasja, dhe çdo herë bëhesha pak më e zhgënjyer dhe disi më dyshuese për efektet e saj.

Njëkohësisht, kisha vënë re se mënyrat se si i përdorja mediat sociale, ishin bërë befaz një pjesë integrale e ekzistencës sime. Dhe kjo ishte diçka, të cilën nuk kisha llogaritur kurrë. Kështu, pasi lexova atë që po thoshin studiuesit e Facebook, vendosa të bëja të vetmen gjë që munda për të çliruar veten nga e gjithë kjo. Nuk çaktivizova vetëm llogarinë timë në Facebook, por dhe atë në Instagram. Ja pse kjo lëvizje ishte 100 për qind mënyra më e mirë për ta nisur vitin e ri.

Kam më pak arsye për t'i zvarritur gjërat që kanë rëndësi për mua

Unë jam një profesioniste e pavarur. Ndaj nëse nuk punoj, nuk paguham. Prandaj, është e drejtë të thuhet se Facebook dhe Instagram po ndikonin negativisht në

punën time, dhe guxoj ta them edhe mbi të ardhurat e mia. Dita ime e zakonshme e punës ishte pak e shumë kjo: kafe, kontroll i emaileve, nisja të shkruaja, kontrolloja Facebook-un, i përgjigjeshatelefonatave, kontrolloja Instagramin, vazhdoja të shkruaja, kontrolloja Facebook-un...

Pra çdo detyrë e lidhur me punën zvarritej për shkak të angazhimit me mediat sociale. Tani që llogaritë në to nuk janë më të aksesueshme, unë nuk kam më mundësi t'i kontrolloj ato. Ndaj arrij të bëj shumë më tepër punë, dhe kam kohë për të bërë punë shtesë, si p.sh. t'i përgjigjem më shumë emaileve, dhe të bisedoj me klientët e mundshëm. Gjithsesi, është një përvojë e vështirë, pasi dëshira për t'u rikthyer sërish më shfaqet disa herë në ditë, gjë që mund të jetë një shenjë se isha e ndërvarur nga përdorimi i mediave sociale.

Nuk më intereson çfarë bëjnë njerëzit e tjerë

Më vjen turp ta pranojë se më interesonte shumë të mësoja se çfarë po bënin të gjithë në rrethin tim shoqëror. Edhe nëse takoheshin vetëm për kafe apo kishin bërë check-in në kinema, pyesja veten se përse nuk isha në listën e të ftuarve, dhe do të filloja të ndihesha shumë e shqetësuar për të gjithë.

Injoranca është vërtetë lumturi. Por do të doja që këtë gjë ta kisha zbuluar më herët. Kur nuk jeni me ta, nuk ka asgjë veçanërisht të dobishme ose produktive të dish se çfarë po bëjnë njerëzit. Për momentin, nuk e kam as idenë më të vogël se çfarë po bëjnë njerëzit që njoh. Dhe e dini çfarë? As që më

intereson. Unë jam duke u marrë me punët e mia, dhe ata po ashtu. A nuk ekzistonte jeta sociale edhe para rrjeteve sociale?

Njerëzit që kanë rëndësi për mua, më kontaktojnë ende

Frika ime më e madhe nga shkëputja përgjithmonë nga rrjetet sociale, ishte se nuk do të kisha asnjë mënyrë për të mbetur në kontakt me njerëzit përreth meje. Nga ngjarjet tek grupet, Facebook ofron një mënyrë shumë të lehtë për të qëndruar në kontakt me rrethet tuaja sociale. Kisha përshtypjen se nëse nuk do të kisha më një profil, do ta kisha të vështirë të ruaja marrëdhëniet e mia, dhe do të isha gjatë gjithë kohës jashtë ciklit figurativ. Fatmirësisht, asgjë nuk mund të ishte më larg të vërtetës. Miqtë e mi dhe anëtarët e familjes që kanë më shumë rëndësi për mua, u përshtatën shumë shpejt me ndryshimin.

Meqë nuk arrita të bëja njoftimin e madh "Unë po largohem nga Facebook!", disa prej tyre me kontaktuan shumë shpejt për të mësuar se çfarë më kishte ndodhur. Në dy javët e fundit, kam pasur më shumë tekste dhe mesazhe se kurrë më parë. E vërteta është se Facebook-u nuk krijon miqësi; është thjesht një platformë. Kur ta braktisni, njerëzit që kanë rëndësi do të jenë ende aty.

Ftesat që marr janë më të sinqerta

Sa shumë ftesa përmes Facebook që merrja dikur! Të ftoheshe në klube e grupime të tëpafundme çdo ditë ishte

rraskapitëse. Shumicën e kohës, këto ftesa nuk ishin kërkesa të sinqerta për pjesëmarrjen time, por një mënyrë për të rritur numrat në faqet e ngjarjeve apo për të shitur bileta para kohe. Sot nuk më mungojnë ftesat për aktivitete të ndryshme, madje ato janë plotësisht të sinqerta.

Ndihem e lirë ta jetoj momentin

Nuk e kisha kuptuar më parë, por në disa aspekte, unë e jetoja jetën time për hir të rrjeteve sociale. Kur dilja për të ngrënë me miqtë ose familjen, bëja gjithmonë një pauzë për t'i bërë një foto ushqimit të shpejtë që po hanim për ta hedhur në Instagram. Sa herë që takoja dikë për të biseduar, do të përdorja Facebook-un për të në check-uar në cilindo bar apo kafene që frekuentonim.

Historia ime në Instagram, ishte vazhdimisht plot me video dhe foto që dokumentonin jetën time të përditshme. Ishte një varësi, një sëmundje. Tani që nuk jam më e detyruar të përditësoj jetën time, gjërat janë pak më ndryshe. Unë ulem për të ngrënë një vakt diku, dhe shoh se si duket pjata për veten time, dhe për askënd tjetër.

Takohem dhe bisedoj me miqtë e mi realisht. Bëj gjëra dhe i shijoj ato pa e menduar fare se sa bukur do të duken në Story-n tim në Instagram. Është çliruese në një mënyrë që nuk e kisha menduar kurrë se mund të ishte, dhe të paktën tani për tani, e dua faktin që po e jetoj jetën time për kënaqësinë time, dhe jo për mediat sociale.

"Reader Digest" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Besa fillon mbrojtjen e titullit në Mitrovicë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Të martën është tërhequr shorti për edicionin 2022/2023 në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Kampionati i ri fillon më 17 shtator, ndërsa garojnë nëntë skuadra. Samadrexha ka hequr dorë nga garimi në Superligë dhe vazhdon garën në Ligën e Parë. Kampione aktuale është Besa Famgas, që në fillim të edicionit sfidohet në Mitrovicë. Besa është mysafire e Trepçës dhe pritet një ndeshje interesante. Interesant pritet të jetë edhe takimi Kastrioti - Vushtrria. Bëhet fjalë për dy skuadra të përforcuara që kanë pretendime në kampionatin e ri. Deçani -

Vëllaznimi dhe Rahoveci - Llapi janë dy ndeshjet e tjera të xhiros së parë. Prishtina është e lirë. Prishtina - Ferizaj është derbi i madh i xhiros së parë në Superligën e Kosovës në hendboll (vajzat). Shorti është tërhequr të martën në lokalet e FHK-së. Shortin e kanë tërhequr komisar i garave Isak Osmani dhe administratori i garave Nikollë Quni. Kampionati 2022/2023 nis më 17 shtator, ndërsa ndeshjet e tjera të xhiros së parë janë: Shqiponja - Vëllaznimi, Dukagjini - Kastrioti, Jusuf Gërvalla - Vushtrria dhe Istogu - Samadrexha. Kampion aktual është Istogu.



Seminar dyditor me trajnerët e klubeve të Superligës së femrave



PRISHTINË, 30 GUSHT - Në kuadër të projekteve të ndryshme të Federatës së Futbollit të Kosovës për masivizimin dhe zhvillimin e futbollit të vajzave/grave, ka filluar seminari dyditor me trajnerët e klubeve të Superligës. Në këtë seminar, krahas drejtorit teknik Albert Bunjaki, po ligjërojnë edhe përzgjedhësja e Përfaqësueses A, Anneli Andersen, ndihmësja Katarina Olsson, drejtoresha e Departamentit të Trajnimeve, Sanije Krasniqi dhe trajneri kondicional i Përfaqësueses, Lekë Tërmmkollli. Qëllimi i këtij seminari është afrimi i klubeve të Superligës me Përfaqësuesen A, transmetimi i përvojës së secilit prej ligjëruesve

te trajnerët, metodologjia e punës në ekipin përfaqësues, ana taktike dhe ajo analitike, por edhe diskutime të ndryshme mbi projekte që mund të shërbejnë në avancimin e futbollit të vajzave/grave. Krahas ligjërimi, trajnerët e klubeve të Superligës do të kenë mundësi të përcjellin nga afër se si organizohet një kamp/grumbullim i Përfaqësueses A, duke përfshirë këtu edhe vëzhgimin e seancave stërvitore, teorike dhe analitike dhe më pas t'i diskutojnë së bashku me ligjëruesit gjatë punimeve të seminarit. Drejtori teknik, Albert Bunjaki, ka thënë se ndër prioritetet e FFK-së ka qenë dhe është masivizimi dhe

përparimi i futbollit të vajzave dhe grave. Sipas tij, synimi për të pasur një ekip kombëtar më cilësor duhet të nisë duke e bërë shtrirjen e futbollit në tërë vendin te vajzat e reja, identifikimin e talenteve, duke krijuar kushte më të mira në klube dhe duke e rritur intensitetin e lojës dhe cilësinë e ligës. Bunjaki tutje ka thënë se pikërisht për këtë arsye është bërë edhe organizimi i këtij seminari në mënyrë që të shfrytëzohen dija dhe përvoja e trajnerëve të përfaqësueses për t'u transmetuar te trajnerët e klubeve tona, por edhe të shihet nga afër se si punohet gjatë një grumbullimi të ekipit përfaqësues.

Jupa transferohet në Gjermani



PRISHTINË, 30 GUSHT - Hendbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Kastriot Jupa, karrierën do ta vazhdojë në Gjermani. Pivoti i parë i Kosovës është transferuar te skuadra LHC Cottbus, që ka synime të mëdha në kampionatin e ri. 29-vjeçari tashmë është bashkuar skuadrës gjermane në fazën përgatitore, ndërsa ka shkëlqyer në ndeshjet kontrolluese. Ai pritet të jetë lojtari kryesor i Cottbusit në kampionatin e ri, ndërsa shpresat e skuadrës për

sukses më së shumti janë të mbështetura në cilësinë e pakontestueshme të hendbollistit kosovar. Për dhjetë vjet Kastriot Jupa ka luajtur për skuadrën pejane Besa Famgas. Me Besën ka dominuar plotësisht në hendbollin kosovar. Plot gjashtë herë është shpallur lojtari më i mirë i vitit në Kosovë. Ai është shquar me paraqitje të mira edhe në kupa evropiane, ndërsa ka vendosur për hapin tjetër në

karrierë. Jupa ka treguar se klubi gjerman është i duhuri për të dhe se tashmë ka gjetur formën më të mirë. Ai është i gatshëm për ndeshjet e ardhshme të Kosovës, ndërsa mezi pret të luajë sërish për ekipin kombëtar. Jupa është kapiteni i dytë i Përfaqësueses së Kosovës. Ka 54 paraqitje deri më tani, që është numri më i lartë në të gjitha ekipet kombëtare të Kosovës, jo vetëm në hendboll, ndërsa i ka shënuar 182 gola.

Prishtina mobilizohet për ndeshjen me Ballkanin

Prishtinë, 30 gusht - FC Prishtina në fundjavë arriti fitore të madhe ndaj Llapit në Podujevë, kurse të njëjtën gjë synon edhe në ndeshjen e radhës kundër kampionit në fuqi, Ballkanit. Prishtina dhe Ballkani do të

përballen në kuadër të javës së pestë në Superligën e Kosovës në futboll të dielën me fillim nga ora 20:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Klubi kryeqytetas u ka bërë thirrje tifozëve të klubit që t'i drejtohen

stadiumit për përkrahje të futbollistëve të udhëhequr nga trajneri Ismet Munishi. "S'ka arsye për mungesa! Krejt Prishtina n'stadium", thuhet në postimin te faja zyrtare e klubit në "Facebook".



Unitedi zyrtarizon Antonyn

MANCHESTER, 30 GUSHT - Skuadra e Manchester Unitedit e ka zyrtarizuar transferimin më të ri, Antony Matheus dos Santos. Përfaqësuesi brazilian i bashkohet kështu gjigantit

britanik nga Ajaxi për 100 milionë euro. Futbollisti ofansiv do ta presë marrjen e lejes së punës dhe më pas të jetë i gatshëm për ekipin e ri. Futbollisti ka nënshkruar

kontratë pesëvjeçare, deri në vitin 2027, me mundësi vazhdimi deri më 2028. 22-vjeçari i realizoi 8 gola dhe i bëri 4 asistime në sezonin e fundit në Eredivisie. Ai nuk

pritet të jetë në dispozicion për duelin e së enjtes ndaj Leicester Cityt, por trajneri Erik ten Hag shpreson ta ketë në dispozicion për përballjen e së dielës kundër Arsenalit.



Muriqi: Ndihem krenar që e kalova Eto'on

MALLORCA, 30 GUSHT - Vedat Muriqi u bë transferimi më i shtrenjtë në histori të Mallorcas, e cila e bleu atë nga Lazio gjatë kësaj vere. Sulmuesi kosovar i kushtoi klubit francez rreth 10 milionë euro pasi dështoi transferimi i tij në Club Brugge, që ofronte më shumë para për "Piratin". Me këtë rast, Muriqi u bë lojtari më i shtrenjtë për të cilin paguan klubi ishullor, duke e kaluar edhe Samuel Eto'on, të cilin Mallorca e kishte blerë për 7,2 milionë euro vite më parë. Dhe, 28-vjeçari ndihet mirë që u bë transferimi më i shtrenjtë i Mallorcas. Për këtë arsye, ai po mundohet ta arsyetojë çdo cent, me angazhim dhe përkushtim maksimal. "Pas asaj që ndodhi në Belgjikë, drejtori i Mallorcas më ka thënë se më do në klubin e tij dhe pa më pyetur nëse kisha probleme fizike, që ishin evidentuar në Club Brugge. Është një motiv i krenarisë që unë jam bërë lojtari më i kushtueshëm i Mallorcas, duke e kaluar edhe Eto'on. Të gjithë e dinë se kush është Eto'o", ka deklaruar Muriqi për "Supersport". "Nga janari jam adaptuar shpejt këtu. Fatmirësisht



kemi mbetur në Liga dhe ishte një kompensim i mirë për mua që Mallorca kërkoi të më blinte. I kam 4 vjet kontratë. Nëse shënon dhe nëse jem gjithçka për klub, tifozët të adhurojnë. Shpresoj që të vazhdoj në këtë mënyrë. Unë jam bërë kështu: e ndiej besimin, jam gjithçka për t'ua shpague. Po

zbavitëm shumë me tifozët dhe me bashkëlojtarët. Kur dal në qytet, gjithmonë më presin mirë", ka shtuar Muriqi. Prizrenasi i ka realizuar dy gola në tri ndeshjet e para të La Ligas, ndërsa për gjysmë sezoni, sa ishte i huazuar nga Lazio, i kishte shënuar 5 gola dhe i kishte bërë 3 asistime.

KOK-u zhvillon takim me përfaqësueset e zyrës së 'Kosovo Erasmus+ Office'

PRISHINË, 30 GUSHT - Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi, sekretari i përgjithshëm Besim Aliti dhe zyrtarja për marrëdhënie ndërkombëtare, Rejhan Halili, kanë pritur në zyrë përfaqësueset e programit Erasmus Plus në Kosovë, Mimika Dobrosi, koordinatorja dhe Blerina Zjaqa, zyrtare për projekte. Qëllimi i takimit ishte ndarja e përvojave dhe informatave në lidhje me dy projektet e fituara nga KOK-u në Bashkimin Evropian përmes programeve të Erasmus Plus. Dy projektet e fituara nga KOK-u janë: "Ngritja e kapaciteteve në fushën e sportit" nën udhëheqjen e Organizatës Sportive Jo Qeveritare të Evropës (ENGSO) dhe "Komiteti Olimpik i Evropës po i afrohet neutralitetit të karbonit (OCEAN)", udhëheqëse e të cilit është zyra e Bashkimit



Evropian për Komitetet Olimpikë të Evropës (EOC EU). Presidenti Krasniqi, duke i falënderuar përfaqësueset e "Kosovo Erasmus+ Office" për vizitën, shprehu vullnetin dhe gatishmërinë për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në projekte të tjera. Për fitimin e këtyre dy

projekteve, koordinatorja Dobrosi ka thënë se është një arritur shumë e madhe dhe një informatë shumë me rëndësi për institucionin e tyre, duke shtuar se ky është një shembull i mirë që mund të ndiqet edhe nga organizatat e tjera joqeveritare (OJQ).

SHKURT

Januzaj, afër kalimit te Venezia

Futbollisti me prejardhje shqiptare, Adnan Januzaj, është larguar nga Real Sociedad, kurse është në kërkim të një skuadre të re. Venezia është skuadër favorite për transferimin e shqiptarit që dikur ishte pjesë e Manchester Unitedit. Klubi italian këtë sezon është pjesëmarrës në Serinë B megjithatë, nëse ia del ta transferojë sulmuesin anësor me origjinë shqiptare, atëherë mund të pretendojë për një rikthim të shpejtë në elitë.

Leclerc dorëzohet: Makina e Red Bullit është shumë përpara nesh

Gara e fundit e Formula 1 zhvilluar në Belgjikë tregoi se Red Bulli e ka vënë me "shpatulla pas muri" Ferrarin, që nuk ishte në gjendje të rivalizojë. Ai që pranon dominimin e makinës austriake është Charles Leclerc, që përfundimisht ka hequr dorë nga gara për titull. "Nuk e di se çfarë i kanë bërë makinës gjatë pushimeve verore. Çfarë magjie kanë bërë për të qenë kaq të shpejtë? Duhet të kuptojmë se çfarë po ndodh, pasi ishin të paarritshëm, ndërsa gara jonë ishte thjesht normale", u shpreh monogasku i "kokëkuqes" që u rendit i gjashti. "Red Bulli ka bërë një hap vërtet shumë të madh përpara. Kjo është e sigurt. Ajo makinë tashmë është shumë përpara nesh. Edhe pse në garë ishim kompetitivë, nuk ishim në nivelin e tyre. Bëhet fjalë për një diferencë të madhe, që mund ta ndërlikojë të ardhmen", ka deklaruar Leclerc.

Bournemouthi shkarkon trajnerin Parker

Në javën e kaluar Liverpooli shkatarroi me 9 gola skuadrën e Bournemouthit. Një rezultat i thellë nga të besuarit e Jurgen Kloppit, të cilët nxorën kështu "mllefin" e ndeshjeve të para të Premierë Ligës ku nuk ia kishin dalë të siguronin fitoren në katër ndeshje. Tri ditë pas kësaj humbjeje skuadra e Bournemouthit ka marrë masa dhe ai që e ka pësuar është trajneri Scott Parker. 41-vjeçari është shkarkuar zyrtarisht pas kësaj disfate në "Anfield". Lajmin e ka dhënë vetë klubi nëpërmjet një komunikate në rrjetet sociale, ndërsa bëhet me dije se përkohësisht vendin e teknikut do ta zë Geri o'Neill.

Ronaldon nuk e dëshiron as Sportingu

Duket se Cristiano Ronaldo po kalon disa nga ditët më të vështira në karrierën e tij. Portugezi është në kërkim të një skuadre që të luajë sërish në Ligën e Kampionëve, por duket se asnjë klub nuk është i interesuar për shërbimet e tij. Siç raporton "The Times", 37-vjeçari kësaj radhe është refuzuar edhe nga Sportingu i Lisbonës. Trajneri i skuadrës portugeze, Ruben Amorim, ka dalë menjëherë kundër një rikthimi të mundshëm të Ronaldos dhe ka kërcënuar klubin se, nëse do të dërgohej një ofertë drejt sulmuesit veteran, ai do të jepte dorëheqje. Kështu situata me Ronaldon vazhdon të jetë në pikëpyetje, duke parë dhe së fundmi as Erik Ten Hag nuk e do më në skuadër, ku është parë ta ketë nisur nga stoli dy ndeshjet e fundit të Manchester Unitedit në kampionat.

Nubeli 'kërcënon' Bayernin: Unë ose Neueri

Portieri Alexander Nubel e ka prishur qetësinë te Bayern Muncheni. 25-vjeçari është në pronësi të bavarezëve deri në vitin 2025, por ndërkohë luan i huazuar në Monaco. Duke parë cilësitë dhe ofertat

e fundit që ka në drejtim të gjermanit, agjentët e kanë detyruar Nubelin që të hidhet në kundërsulm të drejtuesve të klubit gjerman dhe t'i kërkojë garanci teknike për të ardhmen. "Nëse Neuer

vazhdon të jetë titullari i portës së Bayernit, nuk kam ndër mend që të rikthehem. Duhet gjetur zgjidhja më e mirë e mundshme, përndryshe është e kotë që të kthehem sa për ta ngrohur

stolin", ka thënë Nubel. Nga mediet, analistët gjermanë dhe shtypi francez, Nubeli shihet si zëvendësuesi i denjë për portën e gjigantit gjerman. Tani mbetet për t'u parë se si do të veprojnë

drejtuesit në "Allianz Arena" verën e ardhshme, aty ku Manuel Neueri është kthyer në një mit të p a n d r y s h u e s h ë m , pavarësisht moshës 36-vjeçare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Bazuar në nenin 79, 80 dhe nenit 81, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligji nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, Policia e Kosovës shpall:

KONKURSIN

Referenca: 07/1-01SAP-R /584/2022

Për plotësimin e vendeve të punës

1. **Titulli i vendit të punës:** Automekanik- dhjetë (10) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për servisimin e rregullt të Automjeteve të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë dhe njofton mbikëqyrësin dhe përgjegjës për servisimin/riparimin e automjeteve të aksidentuara të PK-së.
- Përgjegjës për riparimin, mënjanimin e problemeve mekanike të automjeteve duke siguruar që të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë, njofton mbikëqyrësin, analizon dhe vlerëson faktorët më të shpeshtë të prishjeve të automjeteve.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjerë të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Të ruaj sekretin e institucionit, duke mos nxjerrë në opinionin publik informata që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kryen edhe detyra tjera që janë të ndërlidhura me këtë natyrë të punës sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

2. **Titulli i vendit të punës:** Autolimar- Pesë (5) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për riparimin të automjeteve të aksidentuara të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Përgjegjës për mënjanimin e dëmtimeve mekanike të karoseris së automjeteve duke siguruar që të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë dhe njofton mbikëqyrësin dhe analizon e bën identifikimin e pjesëve të dëmtuara që mund të riparohen.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësi eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura.
- Përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjerë të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Të ruaj sekretin e institucionit, duke mos nxjerrë në opinionin publik informata që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kryen edhe detyra tjera që janë të ndërlidhura me këtë natyrë të punës sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

3. **Titulli i vendit të punës:** Autoelektricit- Tri (3) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për riparimin dhe instalimin elektrik në automjetet e PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Përgjegjës për riparimet dhe instalimet elektrike të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezerve dhe njofton mbikëqyrësin për furnizim.
- Vlerëson dhe bënë identifikimin e pjesëve të dëmtuara që mund të riparohen.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura.

- Përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjerë të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Kryen edhe pune tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

4. **Titulli i vendit të punës:** Teknik metalpunues (axhustator)- dhjetë (10) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimin e grilave, të dritareve, për vendosjen e tyre në Qendrat e Mbajtjes, nëpër objektet e PK-së.
- Punimin e grilave të dritareve, për vendosjen e tyre në dhomat e dëshmime, në objektet e PK-së.
- Punimin e grilave të dyerve për vendosje në dhomat e dëshmime në objektet e PK- së.
- Riparimin të rrethojave të objekteve për shkaqe sigurie.
- Vendosjen e grilave metalike të objekteve në hapësirat me konfidencialitet të veçantë.
- Ndërrimin e dyerve metalike, në dhomat e dëshmime dhe qendrat e mbajtjes.
- Vendosjen e dyerve metalike në dhomat me konfidencialitet të veçantë.
- Vendosjen e bravave mbrojtëse, nëpër dyer metalike.
- Kryen detyra tjera sipas udhëzimeve të dhëna nga Udhëheqësi i Njesisë së Teknikëve.

Shkollimi dhe shkathtësitë për të gjitha pozitat e kërkuara:

- Të posedoj diplomë të shkollës së mesme.
- Së paku 1 vit përvojë pune.
- Trajnim përkatës.
- Aftësi profesionale dhe motivuese.
- Posedim të standardeve të larta etike.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup, në ambient multietnik.
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Nivel të lartë të ndershmërisë dhe konfidencialitetit.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e Nëpunës administrativ dhe mbështetës janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë një rënë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës, dhe
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Formulari për aplikim;
- Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit dhe pas nënshkrimit nga aplikanti i bashkëngjitet aplikacionit;
- Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës të notifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- Certifikata /ekstraktin e lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumentet nga pika e dhe f duhet të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në intervistë. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë në ankesë.

Informimi i kandidatëve lidhur me rezultatet do të publikohet në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data **31.08.2022** deri me **14.09.2022**.

Mënyra e aplikimit:

Formularët duhet t'i dorëzohen në Njësine për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751dhe 038 245 184.

"Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".



Republika Kosova
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
 Ministry of Internal Affairs
 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
 Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Na osnovu člana 79,80 i člana 81 stav 1. pod stava 2.2. Zakona br. 06/L-114 za Javne službenike, član 8 Zakona br. 03/L-212, o radu, Policija Kosova objavljuje:

KONKURS

Referencija: 07/ 1-01SAP-R/ 584/2022

Za popunjavanje radnih mesta

1. **Naziv radnog položaja:** Automehaničar- deset (10) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike / Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za redovno servisiranje Vozila PK-a, shodno planiranju i zahteva kako bise obezbedilo da sva vozila PK-a, budu funkcionalna.
- Identifikovanje potreba za rezervne delova i upoznavanje nadzornika i odgovornost za servisiranje/ opravku oštećenih vozila PK-a,
- Odgovoran za popravku, otklanjanje mehaničkih kvarova na vozilima, staranje o njihovoj uskladjenosti sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikuje potrebe za rezervnim delovima, obaveštava nadzornika, analizira i procenjuje najčešće faktore kvarova vozila.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladjenost sa odobrenim tehničkim standardima.
- Vodi računa o tome da svaka popravka vozila bude po porudžbini i iskazanim hitnim potrebama i odgovoran je za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama kako bi svaka popravka bila završena prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Da sačuva tajnost institucije, tako da ne daje u javnosti informacije a koje nisu u njegovu nadležnost.
- Obavlja i druge poslove koje su povezane sa njegovom prirodom poslova na zahtev nadzornika i kvalifikacije koje poseduje.

2. **Naziv radnog položaja:** Auto limar- Pet (5) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za opravku osećanih Vozila PK-a, u udesima, shodno planiranju i zahteva kao bise obezbedilo da sva vozila PK-a, budu funkcionalna.
- Odgovoran za popravku, otklanjanje mehaničkih kvarova na vozilima, staranje o njihovoj uskladjenosti sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikovanje potreba za rezervne delova i upoznavanje nadzornika i analizira vrši identifikaciju rezervnih delova koje mogu da se popravljaju.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladjenost sa odobrenim tehničkim standardima.
- Stara se za svaku opravku na vozilima da buzde prema redosledu i hitnim opravdanim potrebama.
- Odgovoran za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama tako da se svaka popravka završi prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Da sačuva tajnost institucije, tako da ne daje u javnosti informacije a koje nisu u njegovu nadležnost.
- Obavlja i druge poslove koji su u vezi sa ovom vrstom poslova po zahtevu rukovodioca i kvalifikacijama koje poseduje.

3. **Naziv radnog položaja:** Auto električar-Tri (3) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za opravku i električnu instalaciju u Vozilima PK-a, u udesima, shodno planiranju i zahteva kao bise obezbedilo da sva vozila PK-a, kako bi bila funkcionalna.
- Odgovoran za popravku i električnu instalaciju da su uskladjena sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikuje potrebe za rezervne delove i obaveštava nadzornika sa snabdevanje.
- Vršiti procenu i identifikaciju oštećenih delova koje mogu da se poprave.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladjenost sa odobrenim tehničkim standardima.

- Stara se za svaku opravku na vozilima da buzde prema redosledu i hitnim opravdanim potrebama.
- Odgovoran za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama tako da se svaka popravka završi prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadzornika i kvalifikacije koje poseduje.

4. **Naziv radnog položaja:** Tehničar metaloprerađivač (varioca-mašinbravar) - deset (10) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Rad rešetaka prozora, njihovo postavljanje u Centrima Zadržavanja, na objektima PK-a,
- Rad rešetaka prozora, njihovo postavljanje u Komorama dokaza, a objektima PK-a,
- Rad rešetaka vrata, njihovo postavljanje u Komorama dokaza, u objektima PK-a,
- Opravku ograda objekata iz bezbednosti razloga,
- Postavljanje metalnih rešetki objekata u prostore sa posebnom poverljivošću,
- Zamenu metalnih vrata, u komorama dokaza i centrima za zadržavanje,
- Postavljanje metalnih vrata u prostorijama sa posebnom poverljivošću,
- Postavljanje zaštitnih brava u prostorijama od posebne poverljivosti.
- Obavlja i druge poslove po nalogu Rukovodioca Tehničke Jedinice.

Obrazovanje i veštine za sve potrebne položaje:

- Da poseduje diplomu srednje škole
- Da ima najmanje 1 godinu, radnog iskustva,
- Odgovarajuću obuku
- Profesionalne i motivisane sposobnosti
- Posedovanje visokih etičkih standarda,
- Da je sposoban za rad u grupi, u multietničkom okruženju,
- Dokazane veštine pismene i usmene komunikacije,
- Visoki nivo poštenosti i poverljivosti

Opšti zahtevi za prijem Administrativnog Službenika i pomoćnika su:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je potpuno sposoban za rad;
- Da poznaje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je zdravstveno sposoban za obavljanje odgovarajućih poslova;
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za izvršavanje krivičnog dela;
- Da nema neku disciplinsku meru za razrešenje sa položaja javnog službenika, obustavljena po ovom zakonu.
- Da imaju nivo obrazovanja i radno iskustvo potrebno za odgovarajući položaju, kategoriju, klasu ili grupu; i
- Da uspešno položiti prijemne procedure, po ovom zakonu.

Potrebna dokumentacija za konkurisanje:

- FORMULARI za apliciranje;
- Izjava (u vezi sa usaglašenosti o istragama prošlosti) može se preuzeti sa ueb-stranice Policije Kosova www.kosovopoliice.com gde se nalazi objavljivanje konkursu i nakon potpisivanja od strane aplikanta prilaže se aplikaciji;
- Kopija diplome o traženoj stručnoj spremi, dok za kandidate koji su školovanje završili u inostranstvu kopiju nostrifikovane diplome;
- Dokazi ostalih kvalifikacija, dokaz o radnim iskustvu;
- Sertifikat / Izvod rodjeni;
- Potvrdu suda da nije kažnjavan i da nije pod istragom;
- Primerak lične karte ili važećeg pasoša;
- Jedna fotografija formata (5 x 5);
- Dokumenta iz tačke e i f moraju biti važeća i izdata posle datuma objavljivanja konkursa.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje:

Na osnovu navedenih zakonskih akata, sve prijave i pristigla dokumentacija biće pažljivo razmotrene i tokom pregleda, ukoliko se utvrdi da kandidat ne ispunjava kriterijume utvrdjene za prijavu i prijem u radni odnos, ili ako prijava sadrži lažne podatke, kandidat će biti odmah diskvalifikovan. Uspešni kandidati biće pozvani da učestvuju na intervjuisanje.

Ovi položaji podvrgavaju se procesu provere i mogu da se popunjavaju nakon uspešnog obavljanja postupka provere.

Na kraju izbornog procesa neizabrani kandidati imaju pravo žalbe.

Obaveštenje kandidata u vezi rezultata objaviće se na ueb-stanici Policije Kosova, na adresi www.kosovopoliice.com, kod rubrike mogućnost zapošljavanja.

Datum početka i završetka konkursa:

Konkurs će biti otvoren 15 dana od **31.08.2022** do **14.09.2022** godine.

Način apliciranja

Obrasci se moraju dostaviti Jedinici za Regrutaciju i Selekciju, Nova Zgrada Administracije, GDP, Priština, lično ili poslati poštom na ovu adresu: **Policija Kosova, ul. "Luan Haradinaj", 10000 Priština, Jedinica za Regrutaciju i Selekciju, III-sprat kancelarija 54, svakog radnog dana od 09:00-15:00 do poslednjeg roka za konkurisanje.** Primljena dokumentacija neće se vratiti!

Zahtevi dostavljeni posle isteka roka neće se prihvatiti. Ne kompletirana dokumentacija može da se odbaci.

Obrasci za apliciranje su na raspolaganju na web stranici Policije Kosova www.kosovopoliice.com gde se nalazi objavljivanje konkursa.

Brojevi za kontaktiranje: Za dodatne informacije možete pozvati na sledeće brojeve telefona za kontaktiranje: 038- 5080 lokal : 1002 /038-504504 lokal:1751 i 038 245 184.

"Policija Kosova služi celom narodu Kosova. "Policija Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građana Republike Kosova, i očekuje aplikacije od svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu "



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.2771 të datës 30.08.2022, Kryeshëfja Ekzekutive i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Konduktër

Numri i pozitave: 20 (njëzetë)

Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi

Periudha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: XIX

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për hyrje dhe dalje të pasagjerëve në çdo stacion të legalizuar të "Trafikut Urban" duke i respektuar standardet e shërbimit;
- Ngarkohet rregullisht me arkë fiskale – letër të saj dhe fletë-urdhëresë të arkës nga Arkëtari apo personi tjetër i autorizuar;
- Ka të ndaluar pirjen e duhanit dhe të kujdeset që edhe pasagjerët të mos pinë duhan në autobus dhe t'i ruan asetet e autobusit duke mos me lënë të dëmtohen;
- Pas përfundimit të orarit të punës kryen llogarinë me kohë dhe dorëzon arkën fiskale në të njëjtën ditë, ndërsa pazarin ditorë në bazë të urdhëresës nga ndërmarrja;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e rendit dhe higjienës në autobus dhe pas çdo relacioni është i obliguar të kontrollojë autobusin dhe ulëset;
- Obligohet që në vendin e punës të ketë uniformen dhe ID-kartelën e ndërmarrjes;
- Është përgjegjës ti furnizojë të gjithë pasagjerët me kupon fiskal në kohë dhe me rregull;
- Të respektoj orarin e punës të përpiluar nga Menaxheri i Transportit;
- Të lajmërohet në punë para fillimit të orarit të punës dhe para nisjes së autobusit të bëjë një kontrollë të brendshme se a është autobusi për nisje;
- Kujdeset për disiplinën në autobus dhe duhet të ketë sjellje korrekte me pasagjerë dhe kontrole;
- Kontrollës së autorizuar të ndërmarrjes është i obliguar ti prezantoj të gjitha dokumentet e kërkuara;
- Nëse për shkaqe shumë të arsyeshme nuk mund të vij në punë, që të mos mbetet autobusi pa konduktër është i obliguar që me kohë ti lajmëroj koordinatoret e linjave dhe të dëshmoj arsyeshmërinë e mos ardhjes në punë;
- Konduktëri e ka të ndaluar të zbres nga autobusi gjatë qarkullimit në linjë;
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të ngarkuara nga Mbikëqyrësi;
- Për punën dhe detyrat e tij i përgjigjet Menaxherit të Transportit.

1. Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme
- Përvojë pune së paku 1 vit
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërliken me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com, apo në formë fizike në administratën e TU-së zyra nr: 5, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00.
Konkursi është i hapur nga data 31.08.2022 dhe përfundon më datë 14.09.2022 në ora 16:00.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
30.08.2022

NPK "Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



U prilog çlanu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.2771 od 30.08.2022.godine, Izvršni direktor NPK „Trafiku Urban“ SH, Priština, objavljuje:

KONKURS

Radno mesto: Konduktër

Broj pozicija: 20 (dvadeset);

Trajanje: Prema važećem ugovoru

Nivo plate: XIX

Dužnosti i odgovornosti:

- Brine o ulasku i izlasku putnika na svakoj legalizovanoj stanici „Trafiku Urban“, poštujući standarde usluge;
- Redovno se puni fiskalnom gotovinom – njenim pismom i nalogom od blagajnika ili drugog ovlašćenog lica;
- Zabranjeno je pušiti i osigurati da putnici ne puše u autobusu i zaštititi imovinu autobusa ne dozvoljavajući da se oštete;
- Po isteku radnog vremena na vreme kompletira račun i istog dana dostavlja fiskalnu kasu, a svakodnevnu kupovinu po narudžbini firme;
- Brine o održavanju reda i higijene u autobusu i nakon svakog putovanja dužan je da proveriti autobus i sedišta;
- Na radnom mestu obavezno imati uniformu preduzeća i ličnu kartu;
- Odgovoran je da na vreme i redovno snabdeva sve putnike fiskalnim kuponima;
- Da poštuje raspored rada koji je sastavio rukovodilac transporta;
- Javite se na posao pre početka rasporeda rada i pre polaska autobusa da izvršite internu proveru da li je autobus spreman za polazak;
- Vodi računa o disciplini u autobusu i mora da ima korektno ponašanje sa putnicima i kontroliše;
- Ovlašćena kontrola preduzeća je dužna da dostavi svu traženu dokumentaciju;
- Ukoliko iz vrlo razumnih razloga ne mogu da dođem na posao, da autobus ne ostane bez konduktera, obavezno na vreme obavestim linijske koordinatore i dokažem opravdanost nedolaska na posao;
- Konduktëri je zabranjeno da izlazi iz autobusa tokom saobraćaja na liniji;
- Obavlja i druge poslove u vezi sa opisom radnih zadataka koje mu odredi supervizor;
- Za svoj rad i dužnosti odgovara rukovodiocu transporta.

1. Kualifikacije i veštine:

- Diploma srednje škole
- Radno iskustvo od najmanje 1 godine
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Nema krivičnog postupka protiv podnosioca predstavke.

2. Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

Način primene:

Prijava se može izvršiti putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com, ili u fizičkom obliku u upravi TU, kancelarija broj: 5, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova.
Konkurs je otvoren od 31.08.2022 i završava se 14.09.2022 u 16:00 časova.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum:
30.08.2022

NPK „Trafiku Urban“ a.d
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, br. 43 – Priština, Kosovo
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com telefon: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.2775 të datës 30.08.2022, Kryeshefja Ekzekutive i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Punëtor Sigurimi

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi

Periudha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: XXI

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron objektet dhe pasurisë së ndërmarrjes në përgjithësi në aspektin e sigurisë fizike.
- Gjatë pranim-dorëzimit të detyrës në libër të veçantë mban evidencë mbi vërejtjet që ka gjatë orarit të tij të punës;
- Nuk e lejon hyrjen dhe prezencën e njerëzve të pa autorizuar gjatë ditës dhe natës në objektet e ndërmarrjes;
- Udhëheqë librin e evidentimit mbi hyrje dhe daljet e automjeteve, punëtorëve dhe personave të tjerë duke evidentuar kohën e hyrjes dhe dalje nga hapësira e ndërmarrjes;
- Në rast të ndonjë parregullsie gjatë procesit të punës mund të kërkon ndihmë nga policia nëse është i penguar në kryerjen e detyrës;
- Është përgjegjës për krejt atë çka humb në ndërmarrje gjatë ndërrimit të tij;
- Pas përfundimit të orarit të rregullt të punës në sektorët e caktuar, bën inspektimin për të verifikuar se a është gjithçka në rregull;
- Duhet të sigurojë, kontrollojë të gjitha pajisjet apo depot se a janë të mbyllura dyert e tyre kur e pranon detyrë;
- Pas çdo ndërrimi duhet të raportoj tek përgjegjësi i sigurimit, për atë që ka ndodhur gjatë ndërrimit;
- Gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të caktuara është i obliguar që të sillet në pajtim me dispozitat e rregullores të ndërmarrjes dhe Kodit të Mirësjelljes dhe Etikës;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të ngarkuara nga Mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të Sigurimit.

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

1.Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme, liçencë për Sigurim Fizik
- Përvojë pune së paku 1 vit
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

